REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MBROJTJES

# PLANI I INTEGRITETIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES

# 2022-2025

Prill 2022

## PLANI I VEPRIMIT

### 1. Fusha e politikave dhe mekanizmave të mbikëqyrjes demokratike

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “*Debat i përmirësuar mbi politikat e mbrojtjes dhe pjesëmarrje më aktive e aktorëve shtetërorë e institucionalë dhe shoqërisë civile*”

| RISKU | MASA QË DO TË MERRET | NJËSIA PËRGJEGJËSE | AFATI | AKTIVITETET | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Mungesa e një politike specifike antikorrupsion për sektorin e mbrojtjes, përveç obligimeve që rrjedhin nga strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit dhe hartimit të planit të integritetit në proces. | Përfshirja në dokumentet e politikave të MM-së të një kuadri orientues për veprimtarinë kundër korrupsionit në sektorin e mbrojtjes. | Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes | Janar 2023 | Përfshirja e informacionit nëDirektivën të Mbrojtjes. | Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes |
| 2. Kryerja e rivlerësimit të rrezikut të integritetit/korrupsionit në MM. | Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit dhe hartimi i Planit të Integritetit të MM<br><br>Koordinimi dhe monitorimi i procesit të vlerësimit të rrezikut të korrupsionit, dhe masave për adresimin e | Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes<br><br>Grupi i punës për hartimin e Planit të Integritetit në MM dhe FARSH | Dhjetor 2023 | Ngritja e grupit të punës në MM.<br><br>Ngritja e grupit të punës në FARSH.<br><br>Trajnimi i grupeve të punës.<br><br>Identifikimi dhe vlerësimi i riskut. | Grupet e punës për hartimin e planit të integritetit në MM dhe FARSH me mbështetjen e CIDS-së |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | tyre në strukturat e vartësisë së MM-së dhe FARSH-it | | | Hartimi i Planit të Integritetit | |
| 3. Mungesa e kryerjes së vlerësimit të rrezikut të integritetit/korrupsionit në SHPFA. | Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit dhe hartimi i Planit të Integritetit të SHPFA<br><br>Koordinimi dhe monitorimi i procesit të vlerësimit të rrezikut të korrupsionit, dhe masave për adresimin e tyre në strukturat e vartësisë FARSH. | Grupi i punës për hartimin e Planit të Integritetit në SHPFA | Dhjetor 2022 | Ngritja e grupit të punës në SHPFA.<br><br>Trajnimi i grupeve të punës.<br><br>Identifikimi dhe vlerësimi i riskut.<br><br>Hartimi i Planit të Integritetit. | Grupi e punës për hartimin e Planit të Integritetit në SHFA me mbështetjen e CIDS-së |
| 4. Mungesa e harmonizimit të dokumenteve strategjike në sektorin e mbrojtjes. | Hartimi i një dokumenti të brendshëm mbi procesin e planifikimit në MM dhe FARSH. | Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes | Qershor 2023 | Ngritja e grupit të punës<br><br>Draftimi i materialit në bashkëpunim me ekspertët. | Grupi i punësme mbështetjen e CIDS-së |
| 5. Procesi i konsultimit në hartimin dhe miratimin e politikave të mbrojtjes priret të jetë shumë i shkurtër dhe jo gjithëpërfshirës. | Hartimi i një dokumenti kuadër për procesin e angazhimit me palë të interesuara dhe publikun gjatë hartimit të dokumenteve të politikave të mbrojtjes. | Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes<br><br>Drejtoria e | Prill 2023 | Draftimi i raportit periodik mbi angazhimin e palëve të interesuare gjatë hartimit të dokumenteve të politikave.<br><br>Publikimi dhe diskutimi | Stafi MM me mbështetjen e CIDS-së |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes<br><br>Grupi i punës | | i raporteve. | |
| 6. Mungesa e një programi të angazhimit me OSHC-në, veçanërisht në drejtim të antikorrupsionit. | Hartimi dhe publikimi i një programi angazhimi me OSHC-në, i cili përmban fushat dhe modalitetet e bashkëpunimit. | Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes<br><br>Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes<br><br>Grupi i punës | Dhjetor 2022 | Hartimi i një programi vjetor për angazhimin e OSHC-së.<br><br>Organizimi i takimeve me OSHC-në. | Grupi i punës me mbështetjen e CIDS |
| 7. Mungesa e vlerësimit të nevojës për hartimin e një plani integriteti në strukturat e varësisë të MM-së | Vlerësimi i riskut të integritetit në strukturat e varësisë. | Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes<br><br>Strukturat e varësisë MM dhe SHPFA | Mars 2023 | Identifikimi i strukturave të varësisë MM dhe SHPFA të cilat plotësojnë kriteret për të pasur një plan integriteti. | Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes në bashkëpunim me CIDS-në<br><br>Strukturat e varësisë MM dhe SHPFA |

## 2. Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: *"Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies*".

| RISKU | MASA QË DO TË MERRET | NJËSIA PËRGJEGJËSE | AFATI | AKTIVITETET | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Mungesa e procedurave standardetë veprimit. | Hartimi dhe miratimi i procedurave standarde të veprimit për secilin proces pune në MM. | Drejtoria e Mirëadministrim-it të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve<br><br>Drejtoritë përkatëse | Dhjetor 2023 | Rishikimi i procedurave ekzistuese.<br><br>Draftimi i procedurave standarde të veprimit për njësitë që mungojnë. | Staf i MM-së me mbështetjen e CIDS-së |
| 2. Mungesë informacioni në lidhje me politikat e privatësisë. | Cikël trajnimesh për të gjithë stafin e Ministrisë lidhur me politikat e privatësisë. | Drejtoria e Mirëadministrim -it të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve<br><br>Drejtoritë e tjera | Dhjetor 2022 | Përfshirja e trajnimit mbi politikat e privatësisë në kalendarin vjetor të trajnimeve të MM-së.<br><br>Organizimi i trajnimeve për politikat e privatësisë. | Stafi MM<br><br>KDIMDP |
| 3. Mungesa e vlerësimit të nevojave për trajnime që duhet të kryhet nga njësia e burimeve njerëzore. | Hartimi i metodologjisë së VNT-së.<br><br>Hartimi i pyetësorit elektronik për VNT-në. | Drejtoria e Mirëadministrim -it të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve | Dhjetor 2023 | Draftimi i metodologjisë për VNT-në.<br><br>Njësia e burimeve njerëzore kryen një herë në vit vlerësimin e nevojave për trajnim për | Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeveme mbështetjen e CIDS-së |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | stafin e MM-së. | |
| 4. Mungesa e një plani vjetor trajnimesh i cili buron nga vlerësimi i nevojave për trajnime. | Hartimi i planit vjetor për trajnime. | Drejtoria e Mirëadministrim-it të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve | Dhjetor 2023 | Njësia e burimeve njerëzore finalizon planin vjetor për trajnime. | Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve |
| 5. Mungesa e trajnimeve për tëgjithë stafin e Ministrisë lidhur me konfliktin e interesit. | Pjesëmarrja e gjithë stafit të MM-së, në trajnimet për konfliktin e interesit. | Drejtoria Mirëadministrim-it të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Drejtoritë e tjera | Dhjetor 2023 | Përfshirja e trajnimit për konfliktin e interesit në planin vjetor të trajnimeve.<br>Organizimi i trajnimeve për konfliktin e interesit. | Stafi i MM-sëdhe Kabineti i ministrit<br>me mbështetjen e CIDS-së dhe ASPA-së |
| 6. Mungesa e njëregjistri dhuratash, deklarate konfidencialiteti, deklarate dypunësimi. | Rishikimi i rregullores së brendshme.<br>Draftimi i kodit të dhuratave pjesë e të cilit do të jetë dhe regjistri i dhuratave, si dhe deklarata për marrjen e një dhurate.<br>Draftimi i deklaratës tip të konfidencialitetit dhe dypunësimit. | Drejtoria e Mirëadministrim-it të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve<br>Drejtoritë e tjera | Qershor 2022 | Miratimi i rregullores së brendshme.<br>Draftimi i regjistrit të dhuratave.<br>Draftimi i deklaratë për konfidencialitetin dhe dypunësimin. | Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeveme mbështetjen e CIDS-së |
| 7. Detyrat që burojnë nga ligje të tilla, si ligji | Përfshirja, në përshkrimet e punës, e | Drejtoria e Mirëadministrim | Qershor 2023 | Rishikimi i përshkrimeve të punës | Drejtoria e Mirëadministrimit të |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| për të drejtën e informimit, ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, ligji për konfliktin e interesit nuk janë të parashikuara në përshkrimin e punës të punonjësit që kryen këto detyra. | detyrave që burojnë nga ligjet e tjera. | -it të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve<br>Drejtoritë respektive | | dhe reflektimi i detyrave që burojnë nga ligjet e tjera. | Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeveme mbështetjen e CIDS-së |
| 8. Ndryshim i koordinatorit për të drejtën e informimit, mungesa e trajnimeve për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror". | Hartimi i një programi të dedikuar trajnimesh për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"<br>Draftimi i një procedure standarde veprime lidhur me trajtimin e rasteve të informacionit të klasifikuar. | Drejtoria e Mirëadministrim it të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve<br>Stafi i MM-së | Dhjetor 2023 | Procedurë standarde veprimi për informacionin e klasifikuar.<br>Organizimi i trajnimeve për të drejtën e informimit dhe informacionin e klasifikuar. | Stafi i MM-së dhe Kabineti i ministritme mbështetjen e CIDS-së<br>AISM<br>SHPFA<br>DSIK |
| 9. Mungesa e trajnimeve për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik. | Hartimi i një kurrikule trajnimi dhe trajnimi i stafeve të drejtorive që hartojnë akte ligjore dhe nënligjore lidhur me procesin e konsultimit publik. | Drejtoria e Mirëadministrim -it të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve<br>Koordinatori për njoftimin dhe | Prill 2023 | Trajnim i vazhdueshëm i koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik. | Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik me mbështetjen e CIDS-së |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | konsultimin publik. | | | |
| 10. Mungesa e trajnimit të rregullt në lidhje me antikorrupsionin dheintegritetin për të gjithë personelin. | Përfshirja e trajnimit për antikorrupsionin dhe integritetin, në planin vjetor të trajnimeve. | Drejtoria Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve | Qershor 2023 | Hartimi i një kurrikule trajnimi antikorrupsion/integritet. | Stafi i MM-së, Kabineti i ministrit, SHPFA<br><br>me mbështetjen e CIDS-së |

### 3. Fusha e auditimit të brendshëm dhe kontrollit.

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “Forcimi i rolit të Drejtorisë së Auditimit të brendshëm, kryerja e auditimeve të performancës,me synim forcimin e integritetit të stafit të MM-së”

| RISKU | MASA QË DO TË MERRET | NJËSIA PËRGJEGJËSE | AFATI | AKTIVITETET | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Mungesa e publikimit të raporteve e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. | Publikimi i raporteve të auditimit dhe monitorimi i faqes së internetit. | Drejtoria e Auditimit<br><br>Sektori Web | Dhjetor 2022 | Publikimi i raporteve të Auditimit të jashtëm dhe e raportit vjetor të auditimit të brendshëm, në programin e transparencës (në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale). | Drejtoria e Auditimit |
| 2. Mungesa e trajnimeve mbi procesin e auditimit të performancëspër stafin e Drejtorisë së Auditit të brendshëm. | Përfshirja e trajnimeve të auditimit të performancës në planin vjetor të trajnimeve. | Drejtoria e Auditimit | Dhjetor 2023 | Organizimi dhe pjesëmarrja në trajnime specifike në lidhje me auditet e performancës. | Drejtoria e Auditimit<br><br>Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve |
| 3. Pika e kontaktit antikorrupsion nuk është caktuar. | Dërgimi i shkresës zyrtare pranë KKK-së, në lidhje me caktimin e pikës së kontaktit antikorrupsion. | Sekretari i Përgjithshëm | Qershor 2022 | Caktimi i pikës së kontaktit antikorrupsion. | Sekretari i Përgjithshëm |

## 4. Fusha e menaxhimit financiar dhe prokurimeve publike.

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: *“Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik”*

| RISKU | MASA QË DO TË MERRET | NJËSIA PËRGJEGJËSE | AFATI | AKTIVITETI | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Mungesa e trajnimeve për koordinatorin e riskut. | Pjesëmarrja në trajnime e koordinatorit të riskut. | Koordinatori i riskut | Prill 2023 | Trajnime të koordinatorit të riskut. | Koordinatori i riskut<br>Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve |
| 2. Ndryshimi i shpeshtë i personelit që mbulon financat në strukturat ushtarake. | Koordinimi i DMBNJSH të MM-së dhe Shtabit për caktimin e kuotave për personel financiar. | Drejtoria Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve | Dhjetor 2023 | Caktimi i kuotave nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, nëbashkëpunim me SHFA-në për personelin financiar. | Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve SHPFA |
| 3. Mungesa e rregullave të veçanta për personelin në sektorë sensitivë, ku duhet rotacion i shpeshtë (prokurimet). | Përfshirja e rregullave për rotacionin e stafit, në rregulloren e brendshme të institucionit. | Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve | Dhjetor 2023 | Hartimi i rregullave të posaçme për rotacionin e stafit gjatë procedurat me risk të tilla, si prokurimet publike etj. | Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve me mbështetjen e CIDS (nëvarësitë procesit të nisur me APP) |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4. Mungesa e transparencës për të gjithë dokumentacionin e hartuar për procesin e prokurimit publik. | Përditësimi i programit të transparencës. | Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve<br><br>Sektori Web | Dhjetor 2022 | Publikimi në programin e transparencës i regjistrit të parashikimeve dhe regjistri i realizimeve të prokurimeve publike. | Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve<br><br>Sektori IT |
| 5. Kontratat e lidhura nga Ministria e Mbrojtjes nuk janë publike. | Përditësimi i programit të transparencës. | Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve<br><br>Sektori Web | Dhjetor 2022 | Publikimi në programin e transparencës i kontratave të lidhura me operatorë të ndryshëm, si dhe publikimi i donacioneve (nëse ka të tilla). | Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve<br><br>Sektori IT |

## 5. Fusha e misioneve ndërkombëtare dhe operacioneve.

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “*Politikë e përmirësuar për adresimin e rreziqeve të integritetit në operacione dhe ndërgjegjësim i plotë i të gjitha niveleve drejtuese dhe komanduese të FA-së mbi këto rreziqe*”.

| RISKU | MASA QË DO TË MERRET | NJËSIA PËRGJEGJËSE | AFATI | AKTIVITETI | BURIMET |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Doktrina Ushtarake e Forcave të Armatosura nuk analizon se si Forcat e Armatosura planifikojnë të trajtojnë dhe adresojnë risqet e integritetit dhe korrupsionit në operacione. | Hartimi i një dokumenti gjithëpërfshirës i cili trajton adresimin e risqeve të korrupsionit në operacione brenda vendit. si dhe në operacionet paqeruajtëse dhe misione në nivelet strategjike, operacionale dhe taktike. | Drejtoria e përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes | Qershor 2023 | Dokumenti i hartuar për adresimin e risqeve të korrupsionit në operacione. | SHPFAdheDrejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes me mbështetjen e CIDS-së |
| 2. Mungesa e udhëzimeve për prokurimet të përshpejtuara gjatë operacioneve ose misioneve. | Hartimi i një rregulloreje për prokurimet në misionet dhe operacionet ndërkombëtare. | SHPFA<br>Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit te Akteve Rregullatore | Qershor 2023 | Ngritja e grupit të punës për draftimin e rregullores.<br>Përcaktimi i afateve për finalizimin e rregullores. | Stafi i MM-sëdhe SHPFA-sëme mbështetjen e CIDS-së |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve | | | |
| 3. MM-ja është institucioni kontrollues i ekzekutivit, ndërsa Kuvendi mbikëqyrës, por për shkak se nuk prodhohen raporte të tilla, mekanizmat e mbikëqyrjes nuk janë aktivizuar. | Përfshirja në dokumentet e politikave të rregullimeve për raportimin dhe llogaridhënien për zbatimin e politikës së integritetit në operacione. | Drejtoria e përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes | Prill 2023 | Dokumenti i politikave rishikohet dhe publikohet. | Stafi i MM-së, FA-së me mbështetjen e CIDS-së |